

**MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
TË ARSIMIT TË LARTË NË
KOSOVË**

(2005-2015)

(Versioni final)

Prishtinë, 2004

Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse e Ministrit

Parathënie

Përmbledhje ekzekutive

Kapitulli 1: Realitete, nevoja dhe sfida

- 1.1. Realitete dhe politika të reja për arsimin e lartë në Kosovë
- 1.2. Problemet e sistemit të arsimit të lartë

Kapitulli 2: Vizioni, parimet, misioni, objektivat strategjike

- 2.1. Vizioni
- 2.2. Parimet
- 2.3. Misioni
- 2.4. Objektivat strategjike

Kapitulli 3: Aspekte dhe prioritete të zhvillimit të arsimit të lartë

- 3.1. Politika dhe legjislacioni
- 3.2. Menaxhimi dhe koordinimi
- 3.3. Sigurimi i cilësisë
- 3.4. Kërkimi shkencor
- 3.5. Mbështetja financiare
- 3.6. Infrastruktura

Kapitulli 4: Zbatimi i strategjisë

- 4.1. Menaxhimi i zbatimit të strategjisë
- 4.2. Plani i zbatimit të strategjisë
- 4.3. Buxheti për realizimin e strategjisë

Shtojca

- A. Banka e të dhënave për arsimin e lartë
- B. Shkurtesat
- C. Lista e kontribuesve në hartimin e Strategjisë së Arsimit të Lartë

Fjala hyrëse e Ministrit

Në kohën e sotme kapaciteti riprodhues dhe inovativ i një shoqërie bashkëkohore varet nga arritjet e saj në fushën e kërkimit shkencor dhe të teknologjisë, ndërkohë që zbatimi i këtyre arritjeve në praktikë varet nga cilësia e burimeve njerëzore të cilat i disponon shoqëria. Arsimi i lartë ka rol primar në ndërtimin e një kapaciteti njerëzor të aftë për t'u ballafaquar me sfidat e kohës, prandaj nuk është e rastit që ky sektor i arsimit është në qendër të reformave, si në vendet e tranzicionit, ashtu edhe në vendet e zhvilluara.

Sistemi i arsimit në Kosovë ka pësuar shumë gjatë dhjetë vjetëve të fundit të shekullit të XX, si në aspektin e cilësisë, ashtu edhe në aspektin e menaxhimit, me gjithë faktin se, falë vetmohimit të qytetarëve dhe organizimit politik, ka arritur të mbijetojë. Në këtë periudhë arsimi i lartë ka qenë në shënjestër të aktivitetit represiv të pushtetit të atëhershëm, pikërisht për shkak të rolit vital që ka për shoqërinë kosovare. Situata e viteve të fundit ka bërë që komunikimi me komunitetin ndërkombëtar akademik të zhvillohet me vështirësi të mëdha. Në këtë periudhë të transformimeve të vullshme në Evropë dhe në rajon kemi mbetur pa disa partnerë të rëndësishëm, ndërkohë që kemi filluar të ndërtojmë partneritete të reja. Prandaj, mund të thuhet se arsimi i lartë në Kosovë, përkundër sfidave dhe problemeve me të cilat ballafaqohet në këtë fazë tranzicioni, po hapëron drejt integriteteve rajonale dhe evropiane. Në një fazë të tillë, çdo shoqëri duhet të mendojë për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të arsimit.

Me gjithë problemet e shumta dhe vullnetin për të bërë ndryshime, e kemi kuptuar se nuk ka zgjidhje të lehta dhe të shpejta për zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë është përcaktuar që ndryshimeve t'i qaset në mënyrë sistematike, duke përfshirë në këtë proces të gjithë faktorët relevantë në shoqëri. Duke u nisur nga ky përcaktim ne do të kërkojmë zgjidhje të cilat do të bëjnë të mundur që vendi ynë të bëhet pjesë e pandashme e hapësirës evropiane të arsimit të lartë e përcaktuar me objektivat e Procesit të Bolonjës; do të krijojmë parakushte që arsimi i lartë të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Strategjia 10-vjeçare e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë është dokumenti që artikulon një vizion për atë se çfarë arsimi të lartë dëshirojmë dhe skicon rrugën për t'i përmbushur objektivat tanë strategjike. Kjo strategji reflekton konsensusin në mes të faktorëve politikë, komunitetit akademik dhe shkencor, studentëve, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë. Kështu do të jetë e mundur që ndryshimi të shihet aty ku duhet: në auditorë, në laboratorë, në biblioteka, në tregun e punës, në shoqëri. Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm shoqëror pa respektim të diversitetit në shoqëri, prandaj në Kosovën që ne jemi duke e ndërtuar me ndihmën e miqve tanë ka vend për të gjithë qytetarët e saj.

Rexhep Osmani

Ministër i Arsimit i Shkencës dhe i Teknologjisë

Parathënie

Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë. Në kuadrin e përmbushjes së kësaj përgjegjësie, MASHT-i ndërmerr elaborimin e një strategjie afatgjatë të zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë me perspektivë 10-vjeçare, e me pjesëmarrjen aktive të faktorëve relevantë. Synimi i kësaj strategjie është t'i kontribuohet ndërtimit të një sistemi bashkëkohor të arsimit të lartë në Kosovë, si promotor i zhvillimit të vendit dhe i përpjekjeve integruese. Dokumenti i strategjisë përcakton piketat e realizimit të ndryshimeve dhe të zhvillimit. Detyra është sfiduese dhe kërkon një angazhim maksimal nga të gjithë ata që punojnë në arsimin e lartë dhe që janë të interesuar për zhvillimin e tij.

Strategjia 10-vjeçare e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë është dokumenti që reflekton konsensusin në mes të faktorëve politikë, komunitetit akademik dhe shkencor, studentëve, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë për një vizion të artikuluar qartë se çfarë arsimit të lartë dëshirojmë dhe skicon rrugën për t'i përmbushur objektivat tona strategjike.

Dokumentu i strategjisë është një propozim për transformimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas një modeli, planifikimi, administrimi dhe menaxhimi më të efektshëm.

Nisma për hartimin e këtij dokumenti të strategjisë ka filluar me themelimin nga ana e MASHT-it e Këshillit të Ekspertëve për Arsimin e Lartë (KEAL), i cili ka udhëhequr një proces planifikimi me pjesëmarrje aktive të të gjitha palëve të interesuara. Në shkurt të vitit 2004 janë organizuar dy punëtori planifikues me kohëzgjatje të përgjithshme prej 5 ditësh, ku janë ftuar ekspertë vendorë dhe të huaj, mësimdhënës universitarë, përfaqësues të studentëve, të subjekteve politike dhe të shoqërisë civile, për të kontribuar në identifikimin e problemeve dhe në hartimin e një kornize të përgjithshme strategjike.

Aktivitetet kanë vazhduar me themelimin e katër grupeve të punës, të cilat janë përqendruar në elaborimin e mëtutjeshëm të segmenteve të ndryshme të dokumentit të strategjisë. Në disa raste janë bërë takime të përbashkëta të të gjitha grupeve të punës për të siguruar një qasje racionale dhe sinergji të veprimit. Përveç kësaj, është organizuar Konferenca Ndërkombëtare "Realitete dhe sfida të reja për arsimin e lartë", në të cilën më se 40 ekspertë ndërkombëtarë dhe 150 ekspertë vendorë kanë dhënë kontribut të çmueshëm për pasurimin e përmbajtjes së dokumentit të strategjisë. Po ashtu, për hartimin e këtij dokumenti janë konsultuar strategjitë e zhvillimit të arsimit të lartë të disa vendeve të botës dhe dokumentet e Procesit të Bolonjës.

Procesi i përgatitjes së dokumentit të strategjisë është realizuar nën kujdesin e drejtpërdrejtë të z. Rexhep Osmani, ministër i arsimit, shkencës dhe i teknologjisë. Një kontribut të veçantë në procesin e përgatitjes së dokumentit të strategjisë kanë dhënë prof. dr. Rexhep Gjergji si drejtues i KEAL, prof.dr. Dukagjin Pupovci, si moderator i procesit të planifikimit dhe prof. dr. Nikoleta Mita si konsulentë.

Dokumentu i strategjisë së zhvillimit të arsimit të lartë ka kaluar në një proces konsultimi të gjerë: me aktorët e drejtpërdrejtë të arsimit të lartë, me grupe të ekspertëve, me grupe të interesuarish dhe me publikun.

Hartimin e dokumentit të strategjisë e kanë ndihmuar financiarisht dhe me logjistikë Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Fondacioni Soros.

PËRMBLEDHJE HYRËSE

Realiteti i ri politik, shoqëror dhe ekonomik në Kosovë është pika nisëse e ndryshimeve dhe e zhvillimeve të reja në fushën e arsimit të lartë. Izolimi dhe zhvillimet politike të periudhës së kaluar kanë rezultuar me një ngecje në zhvillim, e cila vazhdon të jetë evidente edhe në periudhën e pasluftës, megjithë praninë e disa zhvillimeve pozitive në këtë hapësirë.

Transformimi i arsimit të lartë ndodh kur vendi po kalon periudhën e tranzicionit. Agjenda kombëtare ka përcaktuar si pika kryesore: përcaktimin e statusit final politik të Kosovës, zhvillimin ekonomik të vendit, politikat sociale për të krijuar mundësi të barabarta dhe për të vendosur drejtësi për të gjitha grupet etnike dhe të pafavorizuara, si dhe integrimin e vendit në bashkësinë evropiane.

Sistemi i arsimit të lartë nevojitet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i shërbejë rendit të ri shoqëror, t'i përgjigjet nevojave kombëtare dhe t'i përgjigjet realiteteve dhe mundësive të reja.

Me gjithë problemet e shumta dhe vullnetin për të bërë ndryshime, është bërë e qartë se nuk ka zgjidhje të lehta dhe të shpejta për zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë është përcaktuar që ndryshimeve t'u qaset në mënyrë sistematike, duke përfshirë në këtë proces të gjithë faktorët relevantë në shoqëri. Duke u nisur nga ky përcaktim janë kërkuar zgjidhje të cilat do të bëjnë të mundur që vendi ynë të bëhet pjesë e pandashme e hapësirës evropiane të arsimit të lartë e përcaktuar me objektivat e Procesit të Bolonjës. Në këtë kontekst, duke ndërtuar një sistem cilësor e fleksibil të arsimit të lartë që u përgjigjet kërkesave të shoqërisë, do të krijohen parakushte që arsimi i lartë të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Vizioni

Vizioni ynë për zhvillimin e arsimit të lartë në dhjetëvjeçarin e ardhshëm është:

KOSOVA - shoqëri demokratike e integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik.

Ne besojmë se ky vizion dhe programi për realizimin e tij duhet të bazohen në parime dhe qëllime të qarta. Parimet sigurojnë vlerat mbi bazën e së cilave do të vlerësohen sistemi dhe institucionet. Qëllimet dhe objektivat janë piketat sipas së cilave do të orientohet zhvillimi i sistemit dhe i institucioneve. Ato janë një mjet për të transformuar, për të reformuar dhe për të zhvilluar sistemin dhe institucionet sipas parimeve të përcaktuara.

Parimet

Gjykojmë se procesi i transformimit, reformimit, zhvillimit të arsimit të lartë duhet të udhëhiqet nga këto parime: paanësia, demokratizimi, barazia,

shumëllojshmëria, zhvillimi, cilësia, efektshmëria dhe eficientia, liria akademike dhe autonomia institucionale, përgjegjshmëria publike.

Misioni

Parimet e paraqitura më lart orientojnë rrugën e transformimit. Misioni dhe objektivat që do të paraqiten më poshtë janë rezultatet kryesore që priten nga zbatimi i reformës.

Misioni ynë është::

Zhvillimi i një sistemi të efektshëm të arsimit të lartë që i kontribuon ngritjes së mirëqenies së shoqërisë kosovare duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit.

Objektivat strategjikë

Për të realizuar misionin e mësipërm përcaktohen këta objektiva kryesorë:

- Objektiva 1:** Të hartohet dhe zbatohet një politikë arsimore bashkëkohore, gjithpërfshirëse dhe të plotësohet legjislacioni për arsimin e lartë.
- Objektiva 2:** Të avancohet menaxhimi dhe koordinimi në arsimin e lartë.
- Objektiva 3:** Të zhvillohet sistemi i menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë.
- Objektiva 4:** Të ngritet kapaciteti për punë kërkimore-shkencore.
- Objektiva 5:** Të krijohen mekanizma për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e arsimit të lartë.
- Objektiva 6:** Të zhvillohet një infrastrukturë e plotë dhe funksionale për arsimin e lartë.

Zbatimi i strategjisë

Për t'i vënë në jetë objektivat dhe propozimet e paraqitura në këtë dokument MASHT-i do të hartojë një plan zbatimi në konsultim me të gjithë aktorët dhe të interesuarit e sistemit të arsimit të lartë, i cili do të përmbajë politikën dhe mekanizmat e mbështetjes dhe të realizimit të kësaj strategjie dhe do të ngrejë strukturat përkatëse. Konsiderohet i nevojshëm krijimi dhe funksionimi i një këshilli mbikëqyrës për menaxhimin e strategjisë me pjesëmarrës nga MASHT, IAL, organizatat studentore, shoqëria civile, ekonomia. Gjithashtu shihet si e dobishme ngritja dhe funksionimi i një komisioni për monitorimin e strategjisë.

Zbatimi i strategjisë do të kalojë nëpër dy faza.

Faza e parë: 2005- 2009

Në këtë fazë përparësi do t'i jepet plotësimi të dokumentacionit ligjor, hartimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit, rritjes së fondeve në mbështetje të ndryshimeve pozitive, zhvillimit të programeve dhe qasjeve të reja.

Faza e dytë: 2010- 2015

Gjatë kësaj faze përparësi do të kenë zhvillimi i kapaciteteve institucionale, zhvillimi i kapaciteteve intelektuale dhe pilotimi i risive.

Parashikimet për AL në vitin 2015

Parashikohet që në vitin 2015 AL do të ketë këto karakteristika:

- do të jetë i konceptuar dhe i realizuar sipas standardeve bashkëkohore evropiane, sipas objektivave të Procesit të Bolonjës;
- do të jetë i krahasueshëm dhe i konkurrueshëm me AL të vendeve evropiane;
- do të jetë më gjithëpërfshirës;
- do të ofrojë më shumë vende studimi (do të rritet pjesëmarrja e popullatës së grupmoshës 18-25 vjeç së paku 25%);
- do të ofrojë më shumë mundësi zgjedhjeje;
- do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia, mosha, besimi, gjendja sociale;
- do të ofrojë mundësi për zhvillimin e sistemit privat të AL;
- do të ofrojë më shumë programe studimi: universitar, pasuniversitar, arsimit në distancë, të nxënësve gjatë gjithë jetës, arsimit për të rriturit;
- do të ofrojë mësimdhënie më cilësore;
- do të jetë më demokratik;
- do të jetë më transparent;
- do të garantojë specialistë, studime dhe shërbime me cilësi të mirë;
- do të ofrojë infrastrukturë më të plotë dhe më të mirë;
- do të thithë më shumë burime humane, materiale dhe financiare dhe do t'i menaxhojë ato në mënyrë më të efektshme dhe më me eficiencë;
- do të jetë i hapur për bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe të interesuarit për arsimin e lartë;
- do të veprojë si një sistem i mirëkoordinuar;
- do të luajë rolin e agjentit social në shoqëri;
- do t'u përgjigjet më mirë kërkesave të tregut vendas dhe të huaj të punës;
- do të realizojë kërkime në funksion të zgjidhjes së problemeve të shoqërisë dhe të ekonomisë;
- do të rritë besueshmërinë për IAL në vend dhe jashtë tij.

Përmbajtja e këtij dokumenti shtjellohet në katër kapitujt në vijim.

KAPITULLI 1: REALITETE, NEVOJA DHE SFIDA

Ky kapitull paraqet kontekstin që dikton nevojën e zhvillimeve të reja. Në këtë kapitull paraqitet nevoja e transformimit, reformimit dhe e zhvillimit të arsimit të lartë në kushtet e realiteteve dhe të sfidave të reja në Kosovë. Statusi i ri i Kosovës, tendenca e zhvillimit global dhe një sërë problemesh kërkojnë ndryshime, ridimensionime, zgjidhje dhe risi në arsimin e lartë. Në këtë kapitull përshkruhet realiteti i ri në Kosovë i krijuar pas Luftës (1999): aspekti politik, ekonomik, shoqëror, kulturor, arsimor. Paraqitet nevoja për politika të reja arsimore për shkak të realiteteve të reja. Duke prezentuar tablonë e problemeve, ky kapitull përcakton edhe nevojën e ndryshimeve.

1.1. Realitete dhe politika të reja për arsimin e lartë në Kosovë

Realiteti i ri politik, ekonomik, shoqëror, kulturor dhe kërkesat e sfidat e integritimit evropian diktojnë nevojën për transformim, reformim dhe zhvillim të arsimit të lartë.

Transformimi i arsimit të lartë realizohet në një periudhë tranzicioni për vendin. Axhenda kombëtare ka përcaktuar si pika kryesore: përcaktimin e statusit final politik të Kosovës, zhvillimin ekonomik të vendit, politikat sociale për të rritur mirëqenien, për të krijuar mundësi të barabarta, për të vendosur drejtësi për të gjitha grupet etnike dhe të pafavorizuara si dhe integrimin e vendit në bashkësinë evropiane.

Në një kontekst të tillë politika e arsimit të lartë duhet të kapërcejë këto lloj sfidash.

Grupi i parë i sfidave lidhet me nivelin e trashëguar të AL.

AL në periudhën para vitit 1999 ka qenë në një anë të njëjtë me segmentet e tjera kosovare që i kanë rezistuar represionit dhe dhunës së ushtruar nga regjimi serb. Izolimi dhjetëvjeçar i arsimit të lartë në Kosovë ka ndikuar dukshëm në cilësinë e arsimit dhe në krahasueshmërinë e rezultateve të arsimit të lartë me vendet e tjera në rajon. Kryesisht AL është njëjtësuar vetëm me UP-në. Duke e bërë qendrore çështjen e mbijetesës së arsimit të lartë shqiptar, theksi iu vu mësimdhënies, ndërkohë që mbetën jashtë vëmendjes elementë të tjerë si cilësia, kërkimi shkencor, shërbimet për shoqërinë, lidhja me ekonominë, zhvillimi i stafit etj. Njëjtësimi i AL me UP-në dhe mungesa e institucioneve të tjera të arsimit të lartë ka krijuar një sërë problemesh në marrëdhëniet midis shtetit dhe universitetit.

Grupi i dytë i sfidave lidhet me të tashmen, me fazën e tranzicionit.

Konteksti aktual në Kosovë prezentohet me këta tregues. Tri shtyllat e reformës ekonomike në Kosovë janë: përmirësimi i klimës për investime dhe për zhvillimin e sektorit privat; krijimi i një ekonomie më konkurrenente dhe më produktive; të gjitha grupet të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga zhvillimi ekonomik. Arsimi do parë si pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit afatgjatë ekonomik dhe social.

Treguesit e arsimit të lartë në Kosovë (Shih Bankën e të dhënave për arsimin e lartë në Shtojca) flasin qartë për gjendjen dhe nivelin e AL. Ja disa prej tyre:

- Përqindja e studentëve në raport me numrin e popullatës në moshën 18-25 vjeçare për vitin akademik 2003/04 është 12%.
- Numri i universiteteve, fakulteteve dhe i shkollave të larta publike dhe jopublike:
1 Universitet Publik¹, 15 fakultete, 7 shkolla të larta (të gjitha publike)
1 Universitet jopublike
- Numri i studentëve të regjistruar, femra/meshkuj, në institucione publike, jopublike:
Institucionet publike: Institucionet jopublike:
Femra: 11437 Femra: 23
Meshkuj: 13 688 Meshkuj: 39
- Numri i studentëve me nënshtetësi të huaj, të regjistruar në UP është 385.
- Numri i studentëve sipas përkatësive etnike në vitin e parë të studimeve:
6253 shqiptarë 118 boshnjakë 1 turk
- Numri i të diplomuarve për një vit shkollor 2002-2003:
Femra 1194 Meshkuj: 1429
- Numri i personelit mësimor sipas gradave dhe titujve:
Doktor i shkencave: 612 Magjistër: 340.
- Numri i instituteve kërkimore: 2.
- Numri i kompjuterëve në dispozicion të studentëve: 445.
- Numri i kompjuterëve në dispozicion të pedagogëve: 428.
- Numri i kompjuterëve në dispozicion të punonjëseve shkencorë: 8.

Arsimin e lartë në Kosovë ende e karakterizon një orientim rigoroz akademik, si dhe një mentalitet i tipit “qëndro larg biznesit”, i cili bën që të mos ekzistojë një baraspeshë e dëshiruar në mes të ofertës së programeve të arsimit dhe kërkesës së tregut. Ndjenja e fuqishme për statusin publik të arsimit të lartë, plakja kadrovike dhe largimi i trurit nga AL në veprimtari të tjera ose edhe largimi i tij nga vendi janë faktorë që ndikojnë negativisht në ndërtimin e një konsensusi për ndryshime dhe përshtatje releteteve të reja. Përveç kësaj, pas vitit 1999 qeverisja në arsimin e lartë është më e centralizuar se kurrë më parë.

Kjo tablo na ndihmon të kuptojmë se aktualisht ekzistojnë një sërë sfidash kapërcimi i të cilave kërkon politika të reja.

Një nga sfidat kryesore të periudhës së tranzicionit është rritja ekonomike e vendit. Kapitali njerëzor është një element bazë për rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe të shpejtë. Kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë kosovare është pasuria më e madhe e vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor të Kosovës në ofrimin e aftësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Prandaj, qasja e barabartë në një sistem modern të arsimit është gjithashtu një faktor i rëndësishëm për promovimin e zhvillimit modern të ekonomisë dhe ky është kusht i barazisë e mirëqënies sociale si dhe i ngritjes së mirëqënies së minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara. Në Kosovë, në rrafshin individual, niveli arsimor është

¹ Me rastin e dekretimit të Ligjit mbi Arsimin e Lartë (2002/3), i miratuar më 12.05.2004 nga Kuvendi i Kosovës, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën e ka shtuar nenin 10.7, i cili parasheh funksionimin e Universitetit të Mitrovicës (me mësim në gjuhën serbe) në pjesën veriore të Mitrovicës. Për mungesë të plotë të transparencës dhe për arsye të ndryshme politike e objektive, MASHT nuk ka qasje në punën e këtij institucioni, prandaj edhe mungojnë të dhënat relevante për funksionimin e tij.

faktor vendimtar për rritjen e punësueshmërisë dhe për sigurimin e një mirëqenjeje ekonomike. Nivelet e larta të arritjeve në arsimim stimulojnë inovacionet, vetëpunësim dhe ndërmarrësinë në vend dhe në mënyrë thelbësore përshpjetojnë procesin e transferimit të njohurive. Për të gjitha këto arsye, shpenzimet në arsim duhet të shihen si investime, efekti i së cilave do të jetë para së gjithash një zhvillim më i shpejtë ekonomik. Kjo është arsyeja pse Qeveria e Kosovës duhet të caktojë si prioritet rritjen e shpenzimeve publike dhe private në arsim.

Vendosja e një bashkëpunimi me përfaqësuesit e ekonomisë është një sfidë tjetër për arsimin e lartë. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm veçanërisht në procesin e zhvillimit të standardeve dhe programeve të reja mësimore, në garantimin e kushteve të duhura për trajtimin praktik, në rinovimin e bazës materiale dhe pajisjeve, në aftësimin praktik të tutorëve, në përcaktimin e specialiteteve të nevojshme.

Duke parë rëndësinë gjithmonë e më të madhe të arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik, urgjentisht nevojiten të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë.

Një sfidë tjetër është demokratizimi i jetës së vendit. Është pranuar se një nga rolet e rëndësishme të IAL është roli i agentit social në shoqëri. IAL nuk po e luajnë dot këtë rol, ndërsa pjesëmarrja dhe ndikimi i tyre në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë është e pandjeshme.

Legjislacioni aktual, megjithëse siguron liri akademike dhe autonomi për universitetin, nuk ofron një mekanizëm të mjaftueshëm sipas të cilit universiteti dhe MASHT-i mund të punojnë së bashku në mënyrë efektive për promovimin e zhvillimit të institucioneve moderne të arsimit të lartë të përqendruara në rezultate.

Profesionalizmi i lartë është një sfidë tjetër për arsimin e lartë. IAL nuk kanë ndonjë sistem për vlerësimin e gjasave për punësim të studentëve apo masa të tjera me karakter më të gjerë për të vlerësuar efektivitetin e mësimdhënies dhe të programeve.

Grupi i tretë i sfidave lidhet me hapat për integrimin në hapësirën evropiane të AL.

Sfida më e vështirë është arritja e integritit të vendit në bashkësinë evropiane. Në këtë kuadër kërkohet që arsimit të lartë të integrohet në hapësirën evropiane. Ligji për Arsimin e Lartë që është hartur në pajtim me zhvillimet e fundit në sistemet evropiane të arsimit të lartë thekson nevojën që sistemi i arsimit të lartë të Kosovës të reformohet drejt objektivave të parashtruara nga Procesi i Bolonjës. Dy urdhëresat administrative në lidhje me Agjencinë për Akreditim të Kosovës dhe licensimin e bartësve privatë të arsimit të lartë kanë vënë bazat elementare të një sistemi të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Progresi në reformimin e arsimit të lartë është i ngadalshëm. Ka filluar të zhvillohet sektori privat në arsimin e lartë, i cili po tregon shenja inkurajuese të një qasjeje të re të mësimdhënies dhe të nxënies.

Shoqëria e informacionit paraqet kërkesa të reja për aftësitë që duhet të zotërojnë njerëzit, prandaj lind nevoja për arsimim të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës. Të nxënësit gjatë gjithë jetës është mënyra më e mirë për të kënaqur nevojat nga ndryshimi i shpejtë i shoqërisë.

Pavarësisht prej reformave të nisura, sistemi i arsimit të lartë ende nuk është i orientuar drejt rezultateve.

1.2. Problemet e sistemit të arsimit të lartë

Për shkak të rrethanave në të cilat AL punoi në vitet '90, të luftës në Kosovë, të statusit të pazgjidhur të Kosovës, të trajtimit joadekuat të arsimit të lartë nga shteti, të mungesës së fondeve publike dhe të fondeve e burimeve të tjera të dedikuara për AL ekziston një tërësi problemesh të cilat renditen më poshtë në mënyrë të përmbledhur sipas disa aspekteve kryesore.

Në fushën e politikës dhe të legjislacionit

- Politika të pamjaftueshme për arsimin e lartë.
- Legjislacion jo i plotë për arsimin e lartë.
- Nuk ka prioritete të përcaktuara për zhvillimin e sektorëve të arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore.
- Mungon një politikë që bazohet në mekanizmin e kërkesës dhe ofertës për vende studimi në AL.
- Mungon një politikë që krijon mundësi të barabarta për të gjithë.
- Përfshirja e ulët e popullatës në AL.
- Përfshirja e ulët e femrës në AL.
- Përfshirje e ulët e minoriteve në AL.
- Nuk është artikulluar politika për zhvillimin e burimeve njerëzore.
- Mungojnë politikat stimuluese pozitive për mësimdhënës, studentë dhe punë kërkimore-shkencore.
- Politika financiare është e bazuar në qasje të kufizuara.
- Mungon një politikë për shfrytëzimin e potencialit shkencor jashtë Kosovës.
- Vërehet dukuria e largimit të kadrove të reja nga Kosova.
- Kapacitetet absorbuese të AL janë të pamjaftueshme.
- Mungojnë politika dhe programe për përkrahjen e sektorit privat në AL.
- UP identifikohet me AL.

Në fushën e menaxhimit dhe të koordinimit

- Mungon një sistem i mirëfilltë për menaxhim të IAL, që bën të pamundur definimin e qartë të kompetencave, përgjegjësive si dhe të kontrollit të suksesit apo mospjesëmërisë në punë.
- Ka objektiva të paartikulluar qartë dhe të paharmonizuara mirë.
- Mungojnë treguesit të cilët mund të ndihmojnë për ruajtjen dhe ngritjen e cilësisë së punës në secilin proces menaxhues në AL.
- Mungojnë mekanizmat e kontrollit dhe të llogaridhënies në çdo nivel.
- Ushtrimi i shumë funksioneve njëkohësisht, nganjëherë edhe në mungesë të kuadrut, po ndikon në uljen e efektivitetit dhe të kompetencës, gjegjësisht në cilësinë e kryerjes së punës.
- Ka një numër të kufizuar të personelit të kualifikuar konform sistemeve bashkëkohore. Kjo lidhet edhe me mungesën e politikës për zhvillimin e burimeve njerëzore.
- Mungon qasja e integruar në administrimin e sistemit të arsimit si tërësi
- Mungon dialogu ndërmjet institucioneve dhe grupeve të AL (Ministri – Universitet, Rektorat–Fakultete, mësimdhënës– studentë). Kjo rezulton në mosharmonizimin e synimeve (objektivave) me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të efikasitetit dhe të cilësisë së menaxhimit.
- Mungojnë mjetet financiare të dedikuara për menaxhim dhe administrim, që ndikon edhe në motivimin dhe angazhimin e ulët të personelit, por edhe në mungesën e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e punëve.
- Mungesa deri tani e konkurrencës ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë.
- Mungesa e institucioneve private, të kualifikuara mirë, për t'i konkurruar institucionet publike të AL.

- Mungesa e mobilitetit të personelit bën që të mos bëhet bartja e shpejtë dhe e nevojshme e përvijës nga vendet me një sistem të zhvilluar mirë të AL.
- Mosmarrja parasysh e kërkesave, nevojave dhe iniciativave të ardhura nga studentët dhe nga personeli mësimor.
- Dekurajimi i nismave për ndryshime pozitive që vijnë nga studentët dhe nga personeli mësimor dhe shkencor.

Në fushën e sigurisë së cilësisë

- Cilësi e ulët e mësimdhënies në arsimin e lartë.
- Planet dhe programet nuk janë në përputhje me nevojat e kohës.
- Pranimi pa kritere i kuadrit arsimor.
- Mungesa e lidhjes në mes të arsimit të lartë dhe komunitetit.
- Mosfeksionimi i punës praktike.
- Planet dhe programet nuk janë në përputhje me nevojat e kohës.
- Pamjaftueshmëri e kuadrit të kualifikuar.
- Motivimi i dobët i mësimdhënësve.
- Mungon sistemi i sigurimit të cilësisë.
- Mungojnë standardet dhe treguesit për matjen e efektshmërisë së AL-të.
- Ka kapacitete të kufizuara për punë shkencore.
- Studentët nuk aftësohen për tregun e punës.
- Mosnjohja e titujve akademikë jashtë Kosovës.
- Motivimi i dobët i studentëve.
- Mundësi të kufizuara për zhvillim të vazhdueshëm profesional.
- Mungon mobiliteti dhe këmbimi i studentëve dhe i mësimdhënësve.
- Besueshmëri e ulët për IAL.
- Mosnjohja e diplomave dhe e titujve shkencorë jashtë Kosovës.

Në fushën e kërkimit shkencor

- Mungojnë politika dhe programe kombëtare për kërkimet shkencore.
- Legjislacioni për kërkimin shkencor është i paplotë.
- Kërkimi shkencor nuk është vënë në funksion të zgjidhjeve të problemeve të shoqërisë.
- Mungojnë inovacionet dhe evaluimi i tyre.
- Mungon bashkëpunimi ndërkombëtar në hulumtime.
- Mungojnë qasje multidisiplinare në punën kërkimore-shkencore.
- Mësimdhënësit nuk kanë informacion të mjaftueshëm për rezultatet aktuale shkencore.
- Studimet pasdiplomike nuk janë të koordinuara me prioritetet kërkimore.
- Mungojnë standardet për punë shkencore.
- Përvoja kërkimore është e pakët.
- Mungon vlerësimi i nevojave për kërkime shkencore.
- Mungon infrastruktura institucionale për punë shkencore.
- Motivimi i pamjaftueshëm i mësimdhënësve që merren me shkencë.
- Kapaciteti për punë shkencore është i ulët.
- Mungojnë fonde publike dhe burime të tjera të dedikuara për kërkime shkencore.
- Mungojnë projekte shkencore të financuara nga fondet publike dhe burime të tjera.
- Mungojnë mekanizmat për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të të drejtave industriale.

Në fushën e financimit

- Niveli i ulët i mbështetjes financiare për arsimin e lartë.
- Mosvlerësimi i duhur i arsimit dhe nënvlerësimi i shkencës.
- Financim i centralizuar i arsimit të lartë.
- Mungesa e politikave dhe e mekanizmave për burime jobuxhetore (alternative) për financimin e AL-të.
- Mungojnë fonde të dedikuara për kërkime shkencore dhe transfer të dijes
- Mungesë e kriterëve të financimit.
- Mungojnë fonde për mobilitetin e mësimit dhe të studentëve.
- Pozita e vështirë materiale e institucioneve të arsimit të lartë.
- Mungesa e treguesve për të matur efikasitetin e mjeteve të shpenzuara.
- Mungesa e mekanizmave për stimulimin e studentëve dhe të grupeve të pafavorizuara.

Në fushën e Infrastrukturës

- Infrastruktura e arsimit të lartë është e mangët dhe jofunksionale.
- Mungon partneriteti ndërmjet institucioneve të AL dhe të tregut të punës që do të mbështeste rinovimin e bazës materiale dhe të pajisjeve.
- Mungojnë burime financiare për infrastrukturën.
- Mungon vlerësimi i nevojave për infrastrukturën.
- Ekziston një numër i vogël i organizatave dhe i klubeve studentore që zhvillojnë veprimtari kulturore e sportive.
- Mungon komunikimi akademik.
- Literatura bashkëkohore është e pakët.
- Infrastruktura ekzistuese nuk e mbështet një përfshirje më të madhe të studentëve në arsimin e lartë.
- Infrastruktura ekzistuese nuk e mbështet një shumëllojshmëri programesh të arsimit të lartë.
- Infrastruktura ekzistuese nuk mbështet kategorinë e studentëve me nevoja të veçanta.
- Nuk ekziston infrastruktura teknologjike për vlerësimin e punës së IAL nga studentët.

Roli dhe pozita e pavalitshme e studentëve në zhvillimet në arsimin e lartë

- Mostrajtimi i studentëve si partnerë/klientë në AL.
- Informacion i pakët për të drejtat dhe obligimet e studentëve dhe jetën studentore.
- Gatishmëria e ulët e studentëve për pjesëmarrje në iniciativa që shpien nga ndryshimet.
- Interesim i pamjaftueshëm për studim të mirëfilltë.
- Mungesë e kreativitetit të studentëve.
- Mosrespektimi i të drejtave të studentëve.
- Pjesëmarrja joaktive e studentëve në vendimmarrje.
- Angazhimi i pamjaftueshëm i studentëve në organizimin e jetës kulturore-sportive.
- Nuk ka stimulim për studentët.

Siç shihet, problemet dhe pasojat e tyre në AL janë të shumta dhe si të tilla po ndikojnë shumë në moszhvillimin e AL në përgjithësi, në uljen e kredibilitetit të IAL në vend dhe në atë ndërkombëtar, në pamundësinë e harmonizimit të AL me objektivat e Procesit të Bolonjës, në moszhvillimin e vazhdueshëm të kuadrove dhe infrastrukturës ekzistuese.

KAPITULLI 2: VIZIONI, PARIMET, MISIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Ky kapitull përvijon vizionin për zhvillimin e arsimit të lartë në 10 vjetët e ardhshëm, paraqet misionin për realizimin e vizionit dhe specifikon parimet dhe objektivat strategjike mbi të cilat do të bazohet veprimtaria konkrete.

Dokumenti i strategjisë është një propozim për transformimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas një modelimi, planifikimi, administrimi dhe menaxhimi më të efektshëm.

2.1. Vizioni

Vizioni ynë për zhvillimin e arsimit në dhjetëvjeçarin e ardhshëm është:

KOSOVA - shoqëri demokratike e integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik.

Ne besojmë se vizioni dhe programi për realizimin e tij duhet të bazohen në parime dhe qëllime të qarta. Parimet sigurojnë vlerat mbi bazën e së cilave do të vlerësohen sistemi dhe institucionet. Objektivat janë caqet sipas së cilave do të orientohet zhvillimi i sistemit dhe i institucioneve. Ata janë një mjet për të transformuar, për të reformuar dhe për të zhvilluar sistemin dhe institucionet sipas parimeve të përcaktuara.

2.2. Parimet

MASHT-i gjykon se procesi i transformimit, reformimit dhe i zhvillimit të arsimit të lartë duhet të udhëhiqet nga këto parime: paanësia, demokratizimi, barazia, shumëllojshmëria, zhvillimi, cilësia, efektshmëria dhe efienca, liria akademike dhe autonomia institucionale, përgjegjshmëria publike.

2.2.1. Paanësia

Paanësia vendoset nëpërmjet një drejtpeshimi për elementet që qëndrojnë në disbalancë. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë ka disbalanca, pabarazi, padrejtësi, paralelizma. Zbatimi i parimit të paanësisë dhe të drejtpeshimit nënkupton nga njëra anë analizën kritike të disbalancave dhe nga ana tjetër hartimin e një programi transformimi, reformimi dhe zhvillimi që të vendosë raporte të drejta. Transformimi, reformimi dhe zhvillimi i pritur përfshin jo

vetëm eliminimin e formave të diferencimit, por edhe krijimin e kushteve për mundësi të barabarta zhvillimi si për individët, grupet dhe institucionet.

2.2.2. Demokratizimi

Parimi i demokratizimit kërkon që drejtimi i sistemit të arsimit të lartë dhe i institucioneve përkatëse të jetë demokratik, përfaqësues dhe pjesëmarrës. Strukturat dhe procedurat duhet të garantojnë se të gjithë kanë mundësi të thonë fjalën e tyre në marrjen e vendimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Ky parim kërkon që procesi i marrjes së vendimeve të jetë transparent dhe se ata që i marrin dhe i zbatojnë vendimet japin llogari për mënyrat e përmbushjes së detyrave dhe të përdorimit të burimeve. Drejtimi i sistemit të arsimit të lartë dhe i institucioneve përkatëse duhet të rimodelohet sipas këtyre kërkesave.

2.2.3. Barazia

Barazia nënkupton të qenët i barabartë në status, të kesh mundësi të barabarta, të marrësh një trajtim të barabartë, pa diskriminime, pa barriera dhe pa paragjykitime. Ky parim kërkon që të gjithë personave dhe institucioneve të përfshira në arenën e arsimit të lartë, si: personeli mësimor, shkencor, administrativ, studentët, grupet e pafavorizuara, universitetet, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore t'u jepen të drejta të barabarta sipas stausit të tyre, të trajtohen si të barabartë për një zhvillim normal individual dhe institucional dhe për një përmbushje të suksesshme të detyrave dhe të përgjegjësive. Barazia mund të jetë numerike ose proporcionale. Respektimi i barazisë pranohet si një standard minimal i kulturës së sotme morale dhe arsimore.

2.2.4. Shumëllojshmëria

Shumëllojshmëria është një parim që ka marrë rëndësi të veçantë në jetën e sotme. Shumëllojshmëria kulturore, gjinore, moshore, gjuhësore, metodologjike, teknologjike, organizative zhvillon fleksibilitetin, rrit kapacitetet për ndryshim. Shumëllojshmëria mundëson baraspeshën, krijimtarinë, gjerësinë dhe thellësinë. Këndvështrimet e ndryshme nxisin eksplorimin e pikëpamjeve të ndryshme dhe të menduarit divergjent zhvillon dialogun real. Shumëllojshmëria ka një ndikim pozitiv në kapacitetin për të nxënë dhe për të ndryshuar sipas nevojave të situatës. Institucionet që nxisin shumëllojshmërinë mbështetin në fakt vetaktualizimin e anëtarëve të vet. Shumëllojshmëria e mban sistemin dinamik. Zbatimi i këtij parimi në arsimin e lartë nënkupton praninë dhe ndikimin e shumëllojshmërisë në nivel insitucioni dhe individi, burimesh, procesesh, strukturash, programesh, metodologjish, teknologjish, produktesh, rezultatesh.

2.2.5. Zhvillimi

Parimi i zhvillimit nënkupton se duhet të krijohen kushtet që të zhvillohen potencialet e sistemit dhe të individëve. Duke qenë se arsimi i lartë ka një rëndësi të pazëvendësueshme për zhvillimin kulturor, shoqëror dhe

ekonomik të vendit, kërkohet që të arrihet një zhvillim i balancuar i burimeve materiale dhe njerëzore.

2.2.6. Cilësia

Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të pritshmërive të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Përcaktimi i këtyre pritshmërive dhe idealeve do të ndryshojë nga konteksti në kontekst, varësisht nga qëllimet e vëna. Zbatimi i parimit të cilësisë kërkon shërbimet e vlerësimit dhe të akreditimit duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin.

2.2.7. Efektshmëria dhe efienca

Këto parime janë të një rëndësie të veçantë. Një sistem ose institucion i efektshëm funksionon në një mënyrë të tillë që çon drejt realizimit të rezultateve ose objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një skeme të parashikuar. Një sistem ose institucion quhet eficient kur ai funksionon dhe punon mirë dhe siguron rezultate të mira me kosto të pranueshme për shoqërinë. Ai i bën gjërat në mënyrë korrekte dhe i përdor burimet njerëzore, materiale dhe mjetet në mënyrë optimale.

2.2.8. Liria akademike dhe autonomia institucionale

Parimi i lirisë akademike dhe i autonomisë institucionale janë sa të lidhura aq edhe të veçanta. Liria akademike nënkupton mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimtarisë akademike. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, eksperimental dhe krijues si dhe për avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual. Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë administrative për përmirësimin e detyrave akademike dhe arsimore.

2.2.9. Përgjegjshmëria publike

Parimi i përgjegjshmërisë publike qëndron në marrjen e vendimeve dhe në shpenzimin e fondeve. Ky parim kërkon që individët ose institucionet duhet të demonstrojnë veprime të përgjegjshme kundrejt publikut. Së dyti, ai kërkon që individët ose institucionet që marrin fonde publike duhet të raportojnë se si dhe sa mirë i kanë shpenzuar fondet.

MASHT-i mbështet këto parime dhe do t'i mbajë parasysht ato në zbatimin e reformës dhe në vlerësimin e progresit.

2.3. Misioni

Parimet e paraqitura më lart orientojnë rrugën e transformimit. Misioni dhe objektivat që do të paraqiten më poshtë janë rezultatet kryesore që priten nga zbatimi i reformës.

Misioni ynë është:

Zhvillimi i një sistemi të efektshëm të arsimit të lartë që i kontribuon ngritjes së mirëqenies së shoqërisë kosovare duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit.

2.4. Objektivat strategjikë

Për të realizuar misionin e mësipërm përcaktohen këta objektiva kryesorë:

- Objektiva 1:** Të hartohet dhe zbatohet një politikë arsimore bashkëkohore, gjithpërfshirëse dhe të plotësohet legjislacioni për arsimin e lartë.
- Objektiva 2:** Të avancohet menaxhimi dhe koordinimi në arsimin e lartë.
- Objektiva 3:** Të zhvillohet sistemi i menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë.
- Objektiva 4:** Të ngrihet kapaciteti për punë kërkimore - shkencore.
- Objektiva 5:** Të krijohen mekanizma për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e arsimit të lartë.
- Objektiva 6:** Të zhvillohet një infrastrukturë e plotë dhe funksionale për arsimin e lartë.

KAPITULLI 3: ASPEKTE DHE PRIORITETE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

Ky kapitull specifikon tiparet kryesore që do të ketë sistemi i arsimit të lartë në mënyrë që të realizojë vizionin dhe misionin dhe të përballojë sfidat e paraqitura më lart. Janë përcaktuar gjashtë aspekte kryesore të cilat do të jenë objekt transformimi, reformimi dhe zhvillimi dhe gjashtë objektiva kryesorë. Besohet se transformimi, reformimi dhe zhvillimi i parashikuar në këto aspekte do të sjellin një sistem më cilësor, më të efektshëm dhe që do të jetë i krahasueshëm dhe i përafshuar me standardet evropiane.

3.1. POLITIKA DHE LEGJISLACIONI

Objektivi: *Të elaborohet një politikë arsimore bashkëkohore, gjithëpërfshirëse dhe të plotësohet legjislacioni për arsimin e lartë*

Aktiviteti i tërësishëm në këtë aspekt ka për qëllim përfundimtar hartimin, gjegjësisht sigurimin e një legjislacioni të plotë mbi arsimin e lartë të modeluar sipas standardeve bashkëkohore ndërkombëtare. Me këtë legjislacion do të rregullohet e tërë veprimtaria e arsimit të lartë, përfshirë procesin mësimor, aktivitetin kërkimor-shkencor, funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, të drejtat dhe detyrat e tyre, procedurën e zgjedhjes në këto institucione, marrëdhëniet me organizatat e studentëve, ekonominë, grupet e interesuara për arsimin e lartë.

Qëllim tjetër i këtij aktiviteti është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse mbi arsimin e lartë, përmes së cilave do të përcaktohen programet përkatës të AL, angazhimi i subjekteve në AL, numri dhe struktura e përfituesve nga aktiviteti në AL, politika e përdorimit të fondeve publike dhe private të AL.

A. Masat

Politika gjithëpërfshirëse dhe legjislacioni i plotë në arsimin e lartë mund të realizohen përmes ndërmarrjes së këtyre masave:

Masa 1: **Arritja e konsensusit shoqëror mbi rëndësinë e arsimit të lartë për emancipimin e përgjithshëm shoqëror dhe rritjen ekonomike si dhe për mbështetjen më të madhe materiale dhe financiare të tij**

Përshkrimi:

1.1. Kuvendi i Kosovës siguron konsensusin politik dhe shoqëror për përcaktimin e arsimit të lartë si një nga prioritetet e zhvillimit për 10 vjetët e ardhshëm.

1.2. Ndërtimi dhe adoptimi i politikave arsimore përmes përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara: Qeverisë, IAL, të punësuarve në arsim, studentëve, bizneseve dhe shoqërisë civile.

1.3. Do të sigurohet që financimi për arsimin e lartë në raport me BPV të paktën të dyfishohet në raport me vitin 2004.

Masa 2: Rrumbullaksimi i kornizës ligjore të arsimit të lartë, përmirësimi i përhershëm i ligjeve dhe ngritja e kompetencës dhe e shkallës së përgjegjesisë në zbatimin e ligjshmërisë në këtë fushë

Përshkrimi:

2.1. Nomenklatura ligjore e arsimit të lartë në Kosovë harmonizohet në tërësi me atë përkatëse të hapësirës evropiane të arsimit të lartë, për të lehtësuar bashkëpunimin, mobilitetin e pedagogëve, studiuesve dhe të studentëve, për t'u mundësuar studentëve vendas dhe të huaj akumulimin, transferin dhe njohjen e krediteve dhe studimeve në Kosovë dhe në vende të tjera.

2.2. Kuvendi i Kosovës siguron infrastrukturën ligjore mbi veprimtarinë e fondacioneve bamirëse, në të cilin parashihen lehtësime të ndryshme për fondacionet të cilat aktivitetin e vet do ta shtrijnë në përkrahjen e studentëve më të mirë.

2.3. Krijohen të gjitha parakushtet për vënien në veprim të të gjithë mekanizmave përkitazi me rregullat e dypunësimit, dhe të veprimtarive politike. Në veçanti institucionet kosovare përgjegjëse për arsimin e lartë kujdesen për krijimin e një klime dhe të mekanizmave adekuatë premtues për punë dinjitoze dhe civilizuese të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

2.4. Zhvillohen politika që mundësojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të respektimit, gjegjësisht të shkeljes së dispozitave të akteve normative të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

2.5. Institucioni i Ombudspersonit dhe mekanizma të tjerë relevantë do të krijohen pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Masa 3: Integrimi i arsimit të lartë të Kosovës në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore të arsimit të lartë

Përshkrimi:

3.1. Hartohet programi i Qeverisë për zhvillimin afatgjatë të arsimit të lartë në Kosovë.

3.2. Hartohet platforma e zhvillimit të arsimit të lartë të Kosovës sipas objektivave të Procesit të Bolonjës.

3.3. Përcaktohen standardet e arsimit të lartë në Kosovë bazuar në standardet evropiane.

3.4. Nxiten dhe mbështeten politika dhe programe ndërkombëtare bashkëpunimi të institucioneve të AL në të gjitha aspektet e punës së institucioneve të AL.

Masa 4: Ngritja e cilësisë, fleksibilitetit dhe e diversitetit të arsimit të lartë

Përshkrimi:

4.1. IAL nxisin dhe mbështesin politika akademike, të cilat në mënyrë të vazhdueshme sigurojnë rifreskimin e programeve mësimore, shkencore dhe hulumtuese, si dhe zhvillim të programeve të reja, në përputhje me nevojat dhe rrjedhat bashkëkohore. Si pjesë e rifreskimeve programore në arsimin e lartë, parashihet që përdorimi i teksteve mësimore universitare, parimisht, të mos jetë i preferuar për periudha mbi 5-vjeçare.

4.2. Institucionet përgjegjëse të Kosovës për arsimin e lartë financojnë themelimin e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe njëherësh krijojnë kushtet dhe nxisin themelimin e institucioneve private të arsimit të lartë.

4.3. Hartohen politika për përmirësimin e kushteve dhe mundësive për studime, mësimdhënie e kërkim shkencor brenda dhe jashtë vendit.

4.4. Promovohen politika që mundësojnë forma të ndryshme të arsimit të lartë, si: arsimi publik, jopublik dhe privat, arsimi në distancë, arsimi me kohë të plotë dhe të pjesshme, të nxënët gjatë gjithë jetës si dhe politika që u hapin rrugë institucioneve të arsimit të lartë për zhvillimin e programeve fleksibile studimore të cilat u përshtaten nevojave individuale të studentëve, duke përfshirë programe intensive studimore, kurse të akredituara verore, mundësi të zgjedhjes dhe multidisiplinaritet, për t'iu përshtatur kërkesave dhe ndryshimeve dinamike në tregun e punës dhe në tregun e dijës.

4.5. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë do të ngrenë cilësinë e punës dhe do të krijojnë parakushtet, përfshirë dhe sigurinë, të cilat e bëjnë më konkurrent dhe më atraktiv sistemin kosovar të arsimit të lartë për studentë të huaj.

Masa 5: Politika për krijimin e parakushteve për punë cilësore

Përshkrimi:

5.1. Në përputhje me parimet e lirisë akademike dhe autonomisë institucionale, autoritetet kosovare dhe IAL kujdesen për promovimin e politikave që afirmojnë lirinë akademike dhe krijojnë parakushtet institucionale për sendërtimin e saj.

5.2. MASHT dhe të gjitha institucionet e arsimit të lartë, me pjesëmarrjen aktive të studentëve, do të zhvillojnë politika dhe praktika pozitive të cilat parandalojnë dhe luftojnë dukuritë negative duke përfshirë: korrupsionin, plagjiatizmin, nepotizmin, shpërdorimet e detyrës dhe të pozitës, ngacmimet seksuale, konfliktin e interesave, mungesën e profesionalizmit dhe të raporteve korrekte, mosrespektimin e kodit etik të mësimdhënësit etj.

5.3. Në pajtim me dispozitat ligjore, do të krijohen mekanizma përkatës për kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të të gjitha aspekteve të punës shkencore në arsimin e lartë. Këta mekanizma do të bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet përkatëse kompetente për të eliminuar dukuritë negative.

Masa 6: Hartimi i politikave që sigurojnë përfshirje graduale më të madhe të gjeneratave në arsimin e lartë, si dhe të kategorive të ndryshme të këtyre gjeneratave në harmoni me kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës

Përshkrimi:

6.1. Rritet përfshirja e të rinjve (të grupmoshës 18-24 vjeç) në studime në arsimin e lartë në masën prej së paku 25 % deri në vitin 2015.

6.2. MASHT-i dhe IAL kujdesen që të krijojnë politika gjithëpërfshirëse dhe mjedis të përshtatshëm që promovon barazi gjinore, qasje të barabartë dhe diversitet kulturor, etnik, gjuhësor, racial etj.

6.3. Zhvillohen politika për komunikim, ndërlidhje dhe kyçje aktive të dijes nga diaspora në institucionet tona, në njëri anë, si dhe për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së largimit të trurit, në anën tjetër.

6.4. Qeveria dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë kujdesen për krijimin e institucioneve dhe për hartimin e programeve speciale të dedikuara për edukim dhe arsimim të grupeve të pafavorizuara dhe të grupeve të tjera nga spektri i diversitetit gjinor, gjuhësor, etnik, kulturor, racial etj.

6.5. Qeveria dhe institucionet e tjera kompetente kujdesen për ndërtimin e infrastrukturës fizike, e cila lehtëson studimin dhe veprimtarinë e personave me aftësi të kufizuara.

6.6. Institucionet publike të arsimit të lartë do të sigurojnë një kontingjent të caktuar vendesh për studim për studentët nga rajoni, të cilët konkurrojnë për ato vende në kushte konkursi.

Masa 7: Politika financiare mbështetëse për përparimin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor

Përshkrimi:

7.1. Qeveria e Kosovës, bazuar në realitetin kosovar dhe në praktikat pozitive të vendeve në zhvillim, përcakton një politikë financiare që e

mbështet në mënyrë më të efektshme zhvillimin e arsimit në dhjetë vjetët e ardhshëm.

7.2. Ngritja e eficiencës së shfrytëzimit të fondeve për arsim dhe sigurimin e pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë së IAL në menaxhimin e buxheteve të tyre.

7.3. Zhvillohen politika që krijojnë mekanizma sipas të cilëve studentët dhe subjektët e tjerë që dëshirojnë të aftësohen profesionalisht në institucionet e arsimit të lartë duhet të paguajnë për studim, gjegjësisht për aftësim përkatës.

Masa 8: Fuqizimi i rolit të studentëve

Përshkrimi:

8.1. MASHT-i, IAL dhe organizatat studentore zhvillojnë politika që afirmojnë informimin dhe vetëdijësimin e studentëve përkitazi me të drejtat, obligimet dhe aspekte të tjera të jetës studentore, me qëllim të fuqizimit të tyre dhe mbrojtjes nga efektet anësore negative të prirjeve globalizuese.

8.2. Zhvillohen politika që përcaktojnë qartë rolin e organizatave dhe të klubeve studentore në sistemin e AL dhe në organizimin e jetës studentore.

B. Treguesit që do të arrihen

- Arrihet konsensusi për shpalljen prioritet të arsimit të lartë dhe mbështetjen më të madhe finaciare nga Qeveria.
- Përgatitet paketa e plotë ligjore e modeluar sipas standardeve bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare për AL.
- Përgatitet programi aftagjatë i Qeverisë për arsimin e lartë.
- Përgatiten dhe zbatohen programe dhe projekte për integrimin e arsimit kosovar në hapësirën e arsimit të lartë evropian.
- Rritet numri i IAL publike, jopublike dhe private.
- Rritet numri i llojeve, degëve dhe programeve të reja të arsimit të lartë.
- Rritet numri i përgjithshëm i studentëve në AL si dhe numri i femrave, i studentëve nga grupet e pafavorizuara dhe nga radhët e personave me aftësi të kufizuara.
- Rritet numri i të punësuarve në ekonominë kosovare nga radhët e të diplomuarve në AL.
- Zvogëlohet numri i shkeljeve të dispozitave të AL.

3. 2. MENAXHIMI DHE KOORDINIMI

Objektivi: Të avancohet menaxhimi dhe koordinimi në arsimin e lartë

Investimet e mëdha në infrastrukturën fizike dhe akademike të bëra nga donatorë ndërkombëtarë dhe mjetet buxhetore në Periudhën e Pasluftës rezultuan kryesisht me pasurimin e ofertës së programeve akademike në

aspektin sasior, por jo edhe me ngritjen e cilësisë së punës në institucionet e arsimit të lartë. Konsiderohet se një shpërputhje e tillë në mes të investimeve të bëra dhe rezultateve të arritura është shkaktuar në masë të madhe nga dobësitë evidente në menaxhimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të vetë sistemit të arsimit të lartë.

Në kohën e sotme të funksionimit të një mjedisi të ndryshueshëm dhe me kërkesa të shtuara, në kushte të një konkurrence në nivel kombëtar dhe rajonal, është mëse e nevojshme që arsimit të lartë të ketë një qasje ndërmarrëse dhe me orientim drejt tregut. Menaxhimi dhe koordinimi në arsimin e lartë duhet të bëjnë një shkëputje nga mentaliteti i ruajtjes së vlerave tradicionale drejt një mentaliteti të marrjes mbi vete të përgjegjësisë për qasje të reja.

Për këtë arsye, avancimi i menaxhimit dhe koordinimit në arsimin e lartë diktohet si një objektiv strategjik për arritjen e të cilit nevojitet shumë punë dhe angazhim permanent. Pa një menaxhim dhe koordinim efikas nuk mund të paramendohet zhvillimi i një sistemi të arsimit të lartë që është në funksion të ngritjes së mirëqenies në shoqëri.

A. Masat

Në fushën e menaxhimit dhe të koordinimit parashihet të merren këto masa:

Masa 1: Definimi i kompetencave, përgjegjësisë dhe krijimi i sistemit të kontrollit

Përshkrimi:

1.1. Hartohen aktet normative dhe doracakët që përcaktojnë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave udhëheqëse dhe menaxhuese në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të lartë, si dhe raportet në mes të institucioneve në nivele të ndryshme. Veçanërisht, përcaktohen qartë vijat ndarëse në funksionet akademike, menaxheriale dhe qeverisëse në institucionet e arsimit të lartë, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare.

1.2. Ndërtohet një sistem për vlerësim të vazhdueshëm të punës së stafit menaxhues dhe administrativ në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të lartë.

1.3. Krijohen mekanizmat për ushtrimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të lartë.

Masa 2: Sigurimi i transparencës në arsimin e lartë

Përshkrimi:

2.1. Institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat menaxhuese dhe koordinuese në të gjitha nivelet do të sigurojnë:

2.1.1. pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të të gjitha palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes dhe të koordinimit, duke krijuar një klimë të volitshme për bashkëpunim;

2.1.2. publikimin e informacionit relevant, përfshirë dokumentet që kanë të bëjnë me punën akademike, vendimet, raportet e punës, raportet e vlerësimit etj.;

2.1.3. komunikim të vazhdueshëm, të hapur dhe profesional me median, në mënyrë që veprimtaria e IAL të pasqyrohet me besnikëri në opinionin publik.

Masa 3: Ndërtimi i kapaciteteve për administrim më cilësor të arsimit të lartë

Përshkrimi:

3.1. Krijohet një administratë profesionale nëpërmjet trajnimit të stafit të kualifikuar administrativ dhe menaxhues dhe sigurimit të mundësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional për të gjithë anëtarët e këtij stafi.

3.2. Nxiten IAL për pjesëmarrje në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar me qëllim të ngritjes së cilësisë së menaxhimit.

Masa 4: Ndërtimi i një infrastrukture solide informative dhe telekomunikuese

Përshkrimi:

4.1. Krijohet një infrastrukturë informative dhe telekomunikuese që ofron kushte të përshtatshme për:

4.1.1. mbledhjen, përpunimin, analizën dhe prezantimin cilësor të të dhënave me qëllim të avancimit të vendimmarrjes;

4.1.2. komunikimin në mes dhe brenda IAL si dhe me subjekte të tjera të interesuara për arsimin e lartë;

4.1.3. sigurimin dhe përpunimin e të dhënave të vlerësimit nga ana e studentëve;

4.1.4. kryerjen e shërbimeve të shpejta dhe cilësore për klientë.

4.2. Ndërtohet një sistem për menaxhimin e informacionit në arsimin e lartë, i cili siguron informacion të krahasueshëm me sistemet e avancuara të vendeve të tjera.

Masa 5: Sigurimi i stimulimeve për menaxhim të suksesshëm

Përshkrimi:

5.1. Krijohen parakushte ligjore dhe nxiten të gjitha institucionet e arsimit të lartë që menaxhuesit e IAL të stimulohen për punë të suksesshme. Përveç stimulimit material për menaxhues të suksesshëm parashikohet të përdoren edhe forma të tjera të stimulimit, si mirënjohje publike për punën e bërë dhe përparësi për pjesëmarrje në forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Masa 6: Krijimi i një asociacioni koordinimi të institucioneve të arsimit të lartë

Përshkrimi:

6.1. Nxitet dhe ndihmohet krijimi i një asociacioni të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, me kritere të përcaktuara të anëtarësimit, i cili do të bëjë të mundur bashkërenditjen e aktiviteteve të këtyre institucioneve në të gjitha sferat e veprimit të tyre. Ky asociacion do të duhej t'i lehtësonte kontaktet e rregullta në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe t'i përfaqësonte interesat e përbashkëta të këtyre institucioneve brenda dhe jashtë vendit.

B. Treguesit që do të arrihen

- Kompletimi i rregullativës në fushën e sistemit të menaxhimit.
- Paketa për funksionet akademike, menaxheriale dhe qeverisëse në institucionet e arsimit të lartë.
- Paketa e standardeve të menaxhimit të arsimit të lartë.
- Përtëritja e vazhdueshme e personelit në sektorin e arsimit të lartë.
- Funksionimi i llogaridhënies (në kuptim të një shkalle më të lartë të transparencës dhe përgjegjësisë për veprimet e bëra).
- Efektshmëria e stafit joarsimor në institucionet e arsimit të lartë.
- Asociacioni i koordinimit të IAL.
- Funksionimi i dialogut në mes të subjekteve përgjegjëse në arsimin e lartë.

Disa prej këtyre treguesve mund të saktësohen në kohë e në faza të ndryshme të realizimit të strategjisë, varësisht nga detyrat që shtrohen lidhur me dinamikën e ndryshimeve.

3.3. SIGURIMI I CILËSISË

Objektivi: Të zhvillohet sistemi i menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë

Çështja e garantimit të cilësisë dhe monitorimi i saj është bërë një element i rëndësishëm në politikën e arsimit të lartë në kohën e sotme. Shtrimi i çështjes së cilësisë në arsimin e lartë diktohet nga nevoja kombëtare dhe nga prirja për internacionalizimin e arsimit të lartë. Ky interesim dhe shqetësim në lidhje me garancinë e cilësisë buron edhe nga një kontekst i gjerë shoqëror, politik, ekonomik. Një presion i madh ushtrohet mbi institucionet e arsimit të lartë për të justifikuar buxhetin që u jepet atyre. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse përpara shoqërisë dhe duhet të

demonstrojnë se ato po bëjnë përpjekjet e mundshme më të mira për të përdorur me efektivitet burimet që u janë besuar. Në këtë kuadër cilësia është paraparë si një nga parimet kryesore ku do të mbështet zhvillimi i arsimit të lartë në Kosovë në dekadën e ardhshme. Qëllimi final i masave të propozuara për këtë fushë është arritja e një cilësie të krahasueshme me standardet evropiane.

A. Masat

Në fushën e sigurimit të cilësisë parashihen masat vijuese:

Masa 1: Zhvillimi i politikave të Agjencisë për Akreditim të Kosovës (AAK)

Përshkrimi:

1.1. Hartohen politika të vlerësimit të IAL dhe të kërkimit shkencor, të programeve mësimore, të stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, të arritjeve të studentëve, të bazuara në standarde ndërkombëtare.

Masa 2: Ngritja e zyrave për sigurimin e cilësisë në ILA

Përshkrimi:

2.1. Nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë do të kërkohet të ngrenë zyra, të cilat do të merren me sigurimin e cilësisë së punës në institucion. Misioni i këtyre zyrave do të jetë ideimi, drejtimi, organizimi dhe publikimi i veprimtarisë së vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni me qëllim që të garantohet niveli i cilësisë së kërkuar. Këto zyra do të jenë përgjegjëse që sigurimi i cilësisë të bëhet pjesë integrale e menaxhimit rutinor të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënët, si dhe të punës kërkimore që zhvillohet brenda institucionit. Po ashtu zyrat për sigurimin e cilësisë do t'i harmonizojnë sa të jetë e mundur kriteret dhe metodat interne për sigurimin e cilësisë me kriteret dhe metodat e institucioneve të supraordinuara (p.sh. departamenti me fakultet, fakulteti me Universitet etj.). Do të ndahen fonde të veçanta për ndërtimin e kapacitetit të këtyre zyrave, si dhe do të shfrytëzohen përvojat e institucioneve akademike nga vendet e zhvilluara.

Masa 3: Harmonizimi i programeve të studimeve të të gjitha niveleve me objektivat e Procesit të Bolonjës

Përshkrimi:

3.1. Në institucionet publike të arsimit të lartë do të bëhet harmonizimi i programeve të studimeve sipas objektivave të Procesit të Bolonjës (PB). Kriter për vlerësim do të jetë krahasueshmëria me programet e vendet nënshkruese të Deklaratës, si dhe shkalla e punësimit të të diplomuarve dhe e mobilitetit të studentëve. Të gjitha programet e studimeve duhet të përmbajnë në vete kriteret për vlerësim të brendshëm të tyre, si dhe duhet të rishikohen në intervale të rregullta kohore.

3.2. Në institucionet publike të arsimit të lartë do të ndërpritet praktika e studimit me afat të pacaktuar dhe do të aplikohen kritere që do të bëjnë të mundur që të gjithë studentët, në pajtim me dëshirat dhe mundësitë e tyre, të fitojnë shkallën akademike të dëshiruar brenda afateve kohore të parapara me akte normative dhe nga vetë programet e studimeve.

Masa 4: Zbatimi i plotë i Sistemit Evropian për Transferin e Krediteve (ECTS)

Përshkrimi:

4.1. Në të gjitha institucionet e arsimit të lartë që i organizojnë studimet në përputhje me objektivat e PB duhet të funksionojë mekanizmi për transferin e krediteve. Për këtë qëllim, do të ndërtohet kapaciteti i stafit akademik dhe stafit administrativ në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ndërkohë që do të ofrohet asistencë teknike për vënien në funksion të një sistemi të tillë.

Masa 5: Krijimi i kushteve për realizimin e punës praktike

Përshkrimi:

5.1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë do të ndihmohen që të krijojnë kushte për punë praktike të studentëve, përmes pajisjes së laboratorëve, qendrave eksperimentale si dhe përmes ofrimit të ndihmës për vendosjen e bashkëpunimit me sektorë të ndryshëm të veprimtarisë ekonomike dhe shoqërore. Po ashtu, do të vihen në dispozicion të institucioneve të arsimit të lartë fonde të veçanta për financimin e punës praktike.

Masa 6: Pjesëmarrja aktive në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar

Përshkrimi:

6.1. Institucionet e arsimit të lartë do të nxiten për pjesëmarrje aktive në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së planeve dhe të programeve, të mësimdhënies dhe të punës kërkimore si dhe me qëllim të nxitjes së mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve. Për këtë qëllim do të vihen në dispozicion të institucioneve të arsimit të lartë fonde me të cilat do të stimulohet pjesëmarrja në projekte të tilla.

6.2. Do të punohet për ngritjen e zyrave për marrëdhënie me jashtë, të qendrave për këshillim dhe informim në nivel të institucioneve të arsimit të lartë si dhe për koordinimin e punës së tyre.

Masa 7: Stimulime për studentë dhe mësimdhënës

Përshkrimi:

7.1. Do të nxiten institucionet e arsimit të lartë që të zbatojnë stimulime për mësimdhënës dhe studentë të suksesshëm, përfshirë stimulimet financiare. Në veçanti, në universitetet publike do të themelohen fonde për stimulimin financiar të mësimdhënësve që zbatojnë risi në mësim. Gjithashtu, mësimdhënësit dhe studentët e suksesshëm do të stimulohen me anë të mirënjohjeve publike për punën e tyre, si dhe në forma të tjera.

Masa 8: Ngritja e njësisë për administrimin e provimit pranues në institucionet publike të arsimit të lartë

Përshkrimi:

8.1. MASHT-i shqyrton mundësinë për ngritjen e një njësie të veçantë për administrimin e provimit pranues në institucionet publike të arsimit të lartë, e cila mund t'u ofrojë shërbime edhe institucioneve private. Njësia duhet të jetë e pavarur nga institucionet e arsimit të lartë dhe do të vetëfinancohet nga të hyrat e realizuara gjatë provimeve pranuese.

Masa 9: Ofrimi i mundësive për zhvillim të vazhdueshëm të aftësive të mësimdhënies

Përshkrimi:

9.1 Institucionet e arsimit të lartë do të ndajnë fonde të veçanta për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në drejtim të zhvillimit të aftësive të mësimdhënies. Këto fonde do të ndahen nga të hyrat e institucioneve dhe mund të përdoren vetëm për këtë dedikim. Shërbimet e trajnimit sigurohen përmes një procesi të konkurrencës së hapur ndërmjet institucioneve të autorizuara për trajnimin e mësimdhënësve.

9.2. Do të nxitet themelimi i qendrave për mësimdhënie cilësore në universitete dhe hartimi i programeve individuale për zhvillim profesional për çdo mësimdhënës.

Masa 10: Respektimi i kriterëve për avancimet shkencore dhe akademike

Përshkrimi:

10.1. Krijohet infrastrukturë ligjore dhe nxiten praktika për vlerësim të drejtë dhe të gjithanshëm të punës akademike dhe shkencore të personelit të institucioneve të arsimit të lartë. Merren të gjitha masat që avancimi të bëhet në bazë të rezultateve të punës dhe krahasueshmërisë me kriteret e avancimit të stafit akademik në vendet e tjera pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës, duke siguruar cilësi, profesionalizëm dhe transparencë të plotë të procesit të vlerësimit.

Masa 11: Përputhja e planeve dhe programeve me rrjedhat e zhvillimit të shoqërisë, të ekonomisë dhe të tregut të punës

Përshkrimi:

11.1. Institucionet e arsimit të lartë në mënyrë të vazhdueshme bëjnë hulumtimin e nevojave të ekonomisë dhe të shoqërisë kosovare, trendeve të zhvillimit të arsimit dhe të ekonomisë botërore në kuadër të globalizimit, për të përcaktuar nevojën e bashkohësimit të programeve ekzistuese dhe për zhvillimin e programeve të reja. IAL do të kujdesen që planet dhe programet të jenë gjithmonë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. IAL do të zhvillojnë kontakte të rregullta me ekonominë për të bërë identifikimin e nevojave dhe të kërkesave. Identifikimi i këtyre nevojave dhe kërkesave mund të arrihet me anë të: (I) hulumtimeve të rregullta që mund t'i bëjnë institucionet e AL; dhe (II) me anë të përcjelljes së shkallës së punësimit të të diplomuarve sipas profileve. Në planet dhe programet e arsimit të lartë do të përfshihen module që u ndihmojnë studentëve të bëjnë planifikimin e karrierës dhe që u ofrojnë atyre aftësitë kyçe që kërkohen në tregun e punës. Në fondet e ndara nga MASHT-i për këtë qëllim institucionet e arsimit të lartë do të konkurrojnë me elaborate përkatëse.

B. Treguesit që do të arrihen

- Harmonizimi i arsimit të lartë me objektivat e Procesit të Bolonjës.
- Kreditet ECTS transferohen brenda dhe jashtë vendit.
- Zvogëlohet shkalla e braktisjes së studimeve.
- Zvogëlohet kohëzgjatja e përfundimeve të studimeve të larta.
- Rritet mobiliteti i mësimeve dhe studentëve vendorë dhe të huaj.
- Rritet shkalla e përfshirjes së stafit në veprimtari për zhvillim profesional.
- Rritet norma e punësimit të të diplomuarve.
- Ekzistojnë struktura për sigurimin e cilësisë.
- Realizohet vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i IAL.
- Rritet besueshmëria e IAL brenda dhe jashtë vendit.

3.4. KËRKIMI SHKENCOR

Objektivi: Të ngrihet kapaciteti për punë kërkimore-shkencore

Buxheti i pakët për shkencën, vetizolimi i institucioneve kërkimore, si pasojë e mungesës së njerëzve të aftë për t'u përballur me realitete të reja kërkimore-shkencore, shkëputja e kërkimeve shkencore nga nevojat e shoqërisë kanë ndikuar në nivelin e pakënaqshëm të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Realiteti i ri kërkon një qasje të re. Kjo qasje duhet të jetë transformuese dhe zhvilluese. Për të ngritur një sistem të ri të kërkimeve shkencore në Kosovë propozohet të konceptohet një politikë e re, të

plotësohet legjislacioni në mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkëncore, të ngrihen kapacitetet institucionale dhe intelektuale, të përcaktohen standardet e kërkimeve shkencore, të gjenden fondet e nevojshme dhe të kryhen stimulimet përkatëse. Vetëm kështu mund të pritet në të ardhmen që kërkimi shkencor ta luajë rolin e forcës motorike të shoqërisë kosovare. Besohet se masat që vijojnë e mbështesin realizimin e objektivit.

A. Masat

Ngritja e kapaciteteve të përgjithshme për punë kërkimore-shkencore në arsimin e lartë mund të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së këtyre masave:

Masa 1: Krijimi i infrastrukturës ligjore për zhvillimin e kërkimit shkencor

Përshkrimi:

1.1. Kuvendi i Kosovës nxjerr ligjin për aktivitetin kërkimor-shkencor, i cili modelohet sipas standardeve ndërkombëtare, përcakton dhe rregullon këtë aktivitet nëpërmjet parashikimit të procedurave për punë kërkimore-shkencore, stimulim, koordinim dhe planifikim, duke pasur parasysh kushtet ekonomike, politike dhe shoqërore të Kosovës dhe rrethinës së saj.

1.2. MASHT-i harton dhe miraton Rregulloren e Kërkimit Shkencor, ku përcaktohen kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të financimit dhe të vlerësimit të projekteve kërkimore-shkencore.

1.3. Përgatitet paketa ligjore për themelimin e Agjencisë për Koordinimin e Kërkimit-Shkencor (varësisht nga pika 4.7).

1.4. IAL miratojnë aktet e brendshme për disponim dhe shfrytëzim të fondeve të krijuara nga kërkimet shkencore dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

1.5. IAL hartojnë rregullativën për veprimtarinë e komisioneve për avancimet shkencore.

1.6. Hartohet dhe miratohet ligji për pronësinë intelektuale (patentat, licensat dhe përparimet teknike) dhe të drejtën e autorit.

Masa 2: Përcaktimi i përparësive për kërkimet shkencore

Përshkrimi:

2.1. MASHT-i harton programin afatgjatë të kërkimeve shkencore në të cilin përcaktohen fushat prioritare, kriteret dhe fondet për mbështetjen e kërkimeve shkencore.

2.2. Fushat prioritare përcaktohen në bazë të kërkesave të zhvillimit të shoqërisë, të ekonomisë dhe të arsimit të lartë, gjegjësisht për 10 vjetët e ardhshëm programi i kërkimit shkencor i jep përparësi kërkimeve shkencore që mbështesin cilësinë në arsim, transferin e dijes dhe zgjidhjen e problemeve të shoqërisë. Fushat e studimit me interes të veçantë nacional do të kenë trajtim adekuat nga institucionet në kuadër të këtyre prioritetëve.

Masa 3: Sigurimi i fondeve të veçanta për mbështetjen financiare të kërkimeve shkencore

Përshkrimi:

3.1. Qeveria miraton programin afatgjatë për financimin e kërkimeve shkencore.

3.2. MASHT-i dhe IAL sigurojnë fonde për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe transferin e dijes që synohet të arrijnë investimet prej 3.5% të GDP, në harmoni me objektivat e PB.

Fondet për kërkimet shkencore sigurohen nga:

- buxheti i shtetit,
- buxheti i universiteteve,
- bashkëpunimi me ekonominë,
- pjesëmarrja në projekte kërkimore-shkencore ndërkombëtare,
- fondacionet vendase dhe ndërkombëtare

3.3. Qeveria dhe MASHT-i miratojnë kriteret e financimit sipas së cilave rreth 1/3 e buxhetit për IAL realizohet nëpërmjet punës kërkimore, si shtesë e të ardhurave për mësimdhënie dhe punë shkencore.

Masa 4: Krijimi i infrastrukturës institucionale dhe kapaciteteve intelektuale për punë kërkimore-shkencore

Përshkrimi:

4.1. Pranë Qeverisë/MASHT të formohet Këshilli Kombëtar për Kërkimin Shkencor, një bord këshilldhënës i cili shqyrton dhe propozon përparësitë e zhvillimit të shkencës dhe programet kërkimore-shkencore.

4.2. Të gjitha IAL krijojnë njësi të kërkimit shkencor të cilat përgjigjen për përgatitjen e propozimeve të projekteve dhe përcjellin zbatimin e tyre.

4.3. MASHT-i sipas nevojës formon komisione për vlerësim të propozimeve të projekteve shkencore.

4.4. Në kuadër të reformës së studimeve thelemore e me theks të posaçëm në ato të magistraturës dhe të doktoraturës të bëhet aftësimi i kërkuesve shkencorë për përdorimin e teknologjive dhe të metodologjive bashkëkohore të kërkimit shkencor që do të përfshinte në vete fleksibilitetin dhe interdisiplinaritetin.

4.5. Institucionet e arsimit të lartë formojnë një Qendër Kërkimore-Shkencore me karakter referal shkencor për të gjitha institucionet e shkollimit dhe për ato themelore shkencore e cila vendos lidhje bashkëpunimi me Joint Research Center të BE (Qendrën e Kërkimeve të Përbashkëta).

4.6. Harmonizimi i kritereve dhe i procedurave për arritjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë me standardet ndërkombëtare.

4.7. Shqyrtohet nevoja dhe mundësia për formimin e agjencisë e cila do të bashkërendonte aktivitetet kërkimore-shkencore në Kosovë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Kjo agjenci do të ndërmerre masa për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për kërkime shkencore me qëllim të ngritjes së cilësisë përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare sipas kritereve të ERA-së (European Research Area, Zonës Evropiane të Kërkimit).

4.8. Krijohet baza e të dhënave shkencore sipas fushave të kërkimit.

Masa 5: Nxitja e ndërmarrjes dhe e realizimit të projekteve përmes bashkëpunimit ndërkombëtar

Përshkrimi:

5.1. IAL hartojnë programe të veçanta dhe të detajuara për aftësimin e stafit shkencor dhe akademik për përgatitjen e propozimeve për kërkime shkencore pranë fondeve përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

5.2. IAL dhe institucionet e tjera përgjegjëse qeveritare lidhin marrëveshje me partnerë ndërkombëtarë dhe universitete të jashtme për realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.

5.3. Identifikohen projektet kërkimore me karakter rajonal në të cilat mund të angazhohen institucionet e arsimit të lartë.

Masa 6: Hartimi i politikës së botimeve shkencore

Përshkrimi:

6.1. Të gjitha institucionet që bëjnë botime shkencore, në veçanti IAL, formojnë bordet e editimit të revistave sipas standardeve ndërkombëtare.

6.2. Bëhet një stimulim i veçantë i studiuesve që botojnë në revistat me recension ndërkombëtar ose në publikimet e tjera që kanë një editim kompetent dhe me renome ndërkombëtare.

6.3. Sigurohen fonde për parapagim të rregullt për revistat me renome ndërkombëtare dhe stimulohet këmbimi i revistave me partnerë dhe institucione ndërkombëtare.

B. Treguesit që do të arrihen

- Paketa ligjore për zhvillimin e shkencës.
- Programi afatmesëm i Qeverisë për zhvillimin e shkencës.
- Numër i mjaftueshëm i kërkimeve shkencore të cilat kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë.
- Ngritja e sistemit pasuniversitar sipas objektivave të Procesit të Bolonjës.
- Numër i mjaftueshëm i publikimeve me recension ndërkombëtare.
- Fonde të veçanta për punë kërkimore-shkencore.
- Ngrihet infrastruktura institucionale për punë shkencore.

3.5. MBËSHTETJA FINANCIARE

Objektivi: *Të krijohen mekanizma për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e arsimit të lartë*

Arsimi i lartë ka një pozitë të pavolitshme materiale e cila shprehet në cilësinë e pakënaqshme të specialistëve të lartë, në cilësinë e ulët të studimeve dhe në ngadalësimin e proceseve integruese në rrjedhat evropiane dhe më gjerë. Zgjidhja e problemeve të financimit parashikohet të arrihet bazuar në një qasje të re konceptuale dhe menaxhuese të mbështetur në idenë se përderisa arsimit të lartë shihet si promotor i zhvillimit të shoqërisë, përderisa prej tij kanë përfitime si individët edhe shoqëria, si sektori publik edhe ai privat, ai duhet të jetë një nga përparësitë e financimeve të Qeverisë, por kostot e tij duhet të përballohen nga të gjithë përfituesit. Masat e propozuara më poshtë besohet se do të mbështesin transformimet e pritshme në këtë aspekt.

A. Masat

Masa 1: Përmirësimi i pozitës materiale të institucioneve të arsimit të lartë

Përshkrimi:

1.1. Me strategjinë afatgjatë zhvillimore të Kosovës dhe me politikën makroekonomike do të projektohen masat të cilat sigurojnë një pozitë më të volitshme në Bruto Produktin Vendor (BPV), që nënkupton jo vetëm pjesëmarrje më të madhe në buxhet, por edhe në burimet e tjera jashtëbuxhetore të financimit. Kjo pjesëmarrje do të rritet me normë më të shpejtë se rritja e BPV-së. Në politikën buxhetore për vitet e ardhshme, Qeveria e Kosovës krahas masave për ngritjen e buxhetit dhe menaxhimin efikas të konsumit buxhetor, siguron një përmirësim gradual të pjesëmarrjes së arsimit të lartë në konsumin buxhetor me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe të përmirësimit të raportit të popullacionit me arsimim të lartë si parakusht që AL ta realizojë rolin që i takon në zhvillimin afatgjatë të vendit.

1.2. MASHT-i çdo vit do të projektojë nivelin e pagave, mallrave, shërbimeve dhe të investimeve dhe do të identifikojë burimet alternative të të hyrave, të cilat mundësojnë një konkurrencë cilësore të arsimit të lartë, shkencës dhe mësimdhënësve në institucionet e arsimit të lartë, përparimin e pajisshmërisë, rrumbullakësimin e procesit të informatizimit dhe qasje më të mirë të nxënies përmes medimeve elektronike, pra një standard të krahasueshëm me vendet në tranzicion dhe me ato që zbatojnë objektivat e Procesit të Bolonjës.

Masa 2: Politikat dhe mekanizmat për burime jashtëbuxhetore (alternative) për financimin e AL

Përshkrimi:

2.1. Institucionet publike të arsimit të lartë do të shfrytëzojnë një shumëllojshmëri burimesh financiare, që siguron stabilitet dhe standard më të lartë. Përpos nga buxheti, të ardhurat do të sigurohen edhe nga partnerhipi me ekonominë dhe subjektet e tjera, nga komercializimi i punës shkencore, donacionet e jashtme, pagesat e studentëve dhe burimet e tjera. Institucionet e arsimit të lartë do të marrin pjesë në projektet e organeve qeveritare, firmave dhe të organizatave joqeveritare, në projektet arsimore dhe shkencore në rajon dhe më gjerë, si dhe do të ngrenë parqet shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorët, nëpërmjet së cilave do t'u ofrohen shërbime shkencore, financiare, juridike dhe menaxheriale institucioneve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto institucione do t'i sigurojnë të ardhurat e tyre edhe përmes organizimit të mësimin në distancë dhe pa shkëputje nga puna, organizimit të semestrave intensivë dhe kurseve të veçanta me pagesë.

Masa 3: Financimi i decentralizuar i arsimit të lartë

Përshkrimi:

3.1. Synimi themelor i politikave financiare në AL do të jetë ngritja e efikasitetit të shfrytëzimit të burimeve të financimit. Përvojat e deritanishme flasin se duhet të bëhen ndryshime në definimin e përgjegjësive të institucioneve të arsimit të lartë (universiteteve, fakulteteve dhe njësive të tjera akademike) në menaxhimin e financave. MASHT-i dhe IAL, në fillim të çdo viti, në bazë të kriterëve të financimit, do ta bëjnë alokimin e fondeve në llogari të veçanta të IAL (universiteteve, fakulteteve dhe njësive të tjera akademike). Fondet jashtëbuxhetore të cilat i sigurojnë IAL (përmes komercializimit të punës shkencore, donacioneve, diasporës, bashkëpunimit me ekonominë etj.) do të mbahen në llogari të institucioneve të arsimit të lartë.

3.2. Përgjegjësinë për shfrytëzimin e këtyre fondeve do ta kenë institucionet e arsimit të lartë (universiteti dhe njësiti akademike dhe organizative), ndërsa MASHT-i ushtron mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre sipas planit të miratuar.

3.3. Për të siguruar unitetin e politikave, ekzekutimit dhe kontrollit financiar, në nivel të IAL do të ngrihen departamente të veçanta të financave.

3.4. Në MASHT do të themelohet fondi për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe transferin e dijes. Ky fond do të dedikohet para së gjithash për studime që kanë të bëjnë me përparimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe me ngritjen e cilësisë së arsimit.

Masa 4: Përmirësimi i mobilitetit të mësimeve dhe studentëve

Përshkrimi:

4.1. MASHT-i do të ndajë fonde për të përkrahur shkëmbimin e mësimeve dhe të studentëve në bazë të marrëveshjeve që universitetet publike të Kosovës do të nënshkruajnë me universitetet e tjera. Stafi menaxherial i universiteteve dhe institucioneve përkatëse të arsimit të lartë do të hulumtojnë për fonde në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian dhe të tjera që janë të dedikuara për mbështetje të bashkëpunimit në mes të universiteteve (p.sh. Programi TEMPUS).

Masa 5: Përcaktimi i kriterëve të financimit

Përshkrimi:

5.1. Ndarja e buxhetit për AL do të bëhet në bazë të çmimit të koston së studimeve të institucioneve të caktuara. Në studimet themelore do të aplikoheshin nivele të ndryshme të participimit të studentëve, kurse studentët e studimeve të magistraturës dhe të doktoraturës do të paguanin çmimin kushtues. Me qëllim të krijimit të kapacitetit vetanë të nevojshëm për mësime dhe kërkim shkencor, IAL mund të krijojë lehtësira në pagesa.

5.2. Fondet që MASHT-i ofron për arsimin e lartë do të bazohen në një formulë që garanton se të gjithë studentët që financohen nga Qeveria mbarojnë studimet për kohën më të shkurtër të specifikuar. Studentët që përsërisin vitin akademik do të obligohen të paguajnë koston e plotë të studimeve.

5.3. Financimi i IAL do të bëhet në bazë të kriterëve të veçanta (koeficientëve) për kokë studentit, duke pasur parasysh specifikat e programit të studimit. Në formulën e financimit si bazë përdoret numri i studentëve, ku aplikohen peshat specifike të cilat janë të bazuara në koston relative të studimit të programeve përkatëse.

5.4. Në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë pagat bazë do të jenë të nivelizura sipas gradave shkencore dhe akademike, ndërsa niveli real i pagave do të jetë në varshmëri nga performancat individuale, që kanë të bëjnë me zhvillimin profesional, përkushtimin në punë, numrin e studentëve, specifikat e programeve përkatëse.

Masa 6: Stimulimi i drejtimeve deficitare

Përshkrimi:

6.1. MASHT-i dhe universitetet publike krijojnë fonde për stimulimin e programeve në drejtimet deficitare me qëllim të formimit të kuadrove të nevojshme për ekonominë dhe shoqërinë.

Masa 7: Stimulimi i studentëve dhe favorizimi i grupeve të pafavorizuara

Përshkrimi:

7.1. MASHT-i dhe universitetet publike nga mjetet buxhetore, participimi i studentëve dhe burimet e tjera çdo vit parashohin fondet për stimulimin e studentëve. Format e stimulimit për studentë të dalluar do të jenë: bursat, mbështetja për të studiuar jashtë vendit, ndarja e kredive etj. Për studentët me gjendje të vështirë sociale, studentët me aftësi të kufizuara dhe grupet e pafavorizuara, MASHT-i dhe IAL do të përgatisin dhedo të zbatojnë programe të ndryshme favorizuese dhe një mbështetje të veçantë financiare. Po ashtu një favorizim/stimulim duhet të kenë edhe studentët e degëve të caktuara për të cilat interesimi për të studiuar është i vogël, ndërkohë që ekziston nevoja për profile të tilla në tregun e punës ose ekziston interesi shoqëror i përgjithshëm.

B. Treguesit që do të arrihen

- Rritet buxheti për arsimin e lartë.
- Rritet vlera e kontratave për shërbime të IAL.
- Rritet shumica e donacioneve për arsimin e lartë.
- Rritet pjesëmarrja e burimeve jobuxhetore.
- Përcaktohet kostoja për studentë në krahasim me vendet e tjera.
- Shfrytëzimi me kohë dhe sipas planit i mjeteve financiare në arsimin e lartë.
- Ekzistojnë fonde për mobilitet të studentëve dhe mësimdhënësve.

6. INFRASTRUKTURA

Objektivi: Të zhvillohet një infrastrukturë e plotë dhe funksionale për arsimin e lartë

Duke besuar se në një shkallë të konsiderueshme infrastruktura është një element përcaktues për realizimin e ndryshimeve dhe zhvillimeve të pritura, janë paraparë masa që do t'i japin mbështetje infrastrukturës fizike, hapësinore, laboratorike, informatike, teknologjike, informuese, komunikuese.

A. Masat

Masa 1: Hapësira fizike

Përshkrimi:

